REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

**Nr. 710 Prot.** **Tiranë, më 04.07.2016**

**VENDIM Nr. 68, datë 28.06.2016**

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008** "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8 të datës 28.06.2016, pasi shqyrtoi ***Detyrën për përgatitjen e Konceptit të gërmimit arkeologjik të varrit dhe gjetjeve arkeologjike në Apoloni***, paraqitur nga ZAKPA e Apolonisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ***Detyrën për përgatitjen e Konceptit të gërmimit arkeologjik të varrit dhe gjetjeve arkeologjike në Apoloni***, paraqitur nga ZAKPA e Apolonisë.
2. Të realizohet nga ZAKPA gërmimi arkeologjik i shpëtimit dhe dokumentimi i gjetjeve, nën dijeninë e ASHA. Raporti i tyre të paraqitet në KKA e radhës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E KULTURËS - TIRANË

**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë
Tel: ++355 04 45 35 855
email: ***sekretaria.kka@asha.gov.al***
Website: asha.gov.al